



Drejtuar: Bashkimi i Operatoreve Ekonomikë “Sinder AB” shpk dhe “KMK” shpk

Adresa: “Shefqet Ndroqi”, pranë Sanatoriumit, Tiranë

Adresa: Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/Ndertese

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Rikualifikimi i dy shesheve publike në qytetin e Tiranës” i ndarë ne lote si më poshte:

Loti i II: “Rikualifikimi i sheshit në rrugën “Irfan Tomini” me kënd rekreativ”

Nr. References, REF 29529- 07- 05- 2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është **“Rikualifikimi i sheshit në rrugën “Irfan Tomini” me kënd rekreativ”**, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Fondi limit, Loti i dytë: 2.380.516,6 (dy milion e treqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë presje gjashtë) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion në Zbatim të Kontratës së Grantit me nr.12136, datë 15.03.2019, nënshkruar ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Bashkisë Lausanne me objekt **“Rikualifikimi i sheshit në rrugën “Irfan Tomini” me kënd rekreativ”**.

Kohëzgjatja e kontratës: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmartjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve, 3 (tre) muaj.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 19.07.2019 , Ora: 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 28 datë 15.07.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**
oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Shendelli” shpk NUIS K07924803N

Çmimi total i ofertës pa tvsh= **1,898,475** (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) **lekë**

2 Bashkimi Operatoreve Ekonomik “Sinder AB” shpk dhe “KMK” shpk NUIS K01531003W& NUIS L78223801E

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **2,356,565.01** (dy milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë zero një) **lekë**.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “Shendelli” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

- Operatori Ekonomik “Shendelli” shpk, nuk plotëson pikën 11 DST të Kapacitetit Teknik të DST: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9). dy kamiona veshkarkues me kapacitet mbajtës min 5 ton-maks 10 ton .* Operatori Ekonomik, ka deklaruar një kamion vetshkarkues, i cili plotëson kërkesat e kërkuara nga AK, në dokumentat standarte të tenderit.
- Operatori Ekonomik “Shendelli” shpk, nuk plotëson pikën 11 DST të Kapacitetit Teknik të DST: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9).* Operatori Ekonomik, ka deklaruar një autobot uji, i cili nuk plotëson kërkesat e kërkuara nga AK, në dokumentat standarte të tenderit.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik i mësipërm është i paplotë pasi nuk kanë përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur dokumentacionin e duhur në mënyrën e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit të kërkuar nga AK

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të

Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Janë shpallur si ofertues të suksesshëm:

1. Bashkimi Operatoreve Ekonomik “Sinder AB” shpk dhe “KMK” shpk, klasifikohet në vend të parë.

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **2,356,565.01** (dy milion e treqind e pesëdhjete e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë zero një) **lekë.**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **2,827,878.01** (dy milion e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë zero një) **lekë.**

Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 3 (tre) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.07.2019

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, **Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “Sinder AB” shpk dhe “KMK” shpk me NUIS K01531003W& NUIS L78223801E**, me adresë: “Shefqet Ndroqi”, pranë Sanatoriumit, Tiranë dhe me adresë: Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/Ndertese, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa tvsh = **2,356,565.01** (dy milion e treqind e pesëdhjete e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë zero një) **lekë**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar